



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 24 maj 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Versioni i Korrigjuar i

Vendimit mbi Kërkesat e ZPS-së F01435 dhe F01508

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të
Specializuar**
Aleks Uajting

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të nenit 40(5) dhe (6)(h) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 137(1), 154 dhe 155 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 7 shkurt 2023, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") parashtroi mocion sipas rregullës 154 në lidhje me shtatë dëshmitarë ("Mocioni i Parë sipas Rregullës 154").¹
2. Më 1 mars 2023, ZPS-ja parashtroi mocion sipas rregullës 155 në lidhje me 16 dëshmitarë ("Mocioni sipas Rregullës 155").²
3. Më 24 mars 2023, ZPS-ja parashtroi mocionin e dytë sipas rregullës 154 në lidhje me nëntë dëshmitarë ("Mocioni i Dytë sipas Rregullës 154").³
4. Më 6 prill 2023, ZPS-ja parashtroi kërkesë lidhur me disa materiale në lidhje me: (i) Mocionin e Dytë sipas Rregullës 154 dhe, më konkretisht, W04577-ën; dhe (ii) Mocionin e Parë sipas Rregullës 154 dhe, më konkretisht, W04474-ën ("Kërkesa e Parë").⁴
5. Asnjë nga ekipet e Mbrojtjes nuk u përgjigj ndaj Kërkesës së Parë.

¹ F01262, Prokurori i Specializuar, *Mocion i Prokurorisë për Pranimin e Provave të Dëshmitarëve W04474, W04421, W04355, W02161, W01236, W04337, dhe W03165 sipas Rregullës 154*, 7 shkurt 2023, konfidencial, me Shtojcat 1-7, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 31 mars 2023, F01262/RED).

² F01329, Prokurori i Specializuar, *Mocioni i Parë i Prokurorisë për Pranimin e Provave sipas Rregullës 155*, 1 mars 2023, konfidencial, me Shtojcat 1-17, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 16 mars 2023, F01329/RED).

³ F01396, Prokurori i Specializuar, *Mocion i Përditësuar i Prokurorisë për Pranimin e Provave të Dëshmitarëve W03827, W04408, W04577, W04644, W04781, W04018, W04255, W01493, dhe W04448 sipas Rregullës 154*, 24 mars 2023, konfidencial, me Shtojcat 1-9, konfidenciale.

⁴ F01435, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë Lidhur me Materialet në Lindje me W04577-ën dhe W04474-ën*, 6 prill 2023, konfidenciale.

6. Më 8 maj 2023, ZPS-ja dorëzoi kërkesë lidhur me disa materiale në lidhje me Mocionin sipas Rregullës 155 dhe, më konkretisht, W02618-ën (“Kërkesa e Dytë”).⁵

7. Asnjë nga ekipet e Mbrojtjes nuk u përgjigj ndaj Kërkesës së Dytë.

II. PARASHTRIMET DHE DISKUTIM

A. KËRKESA E PARË (F01435)

8. Lidhur me W04577-ën, ZPS-ja kërkon që Trupi Gjykses: (i) të pranojë transkriptet e rishikuara dhe përkthimet e pjesshme të nxjerra nga ZPS-ja në Paketën 745 të Materialit të Nxjerrë të 5 prillit 2023, në vend të transkripteve përkatëse të identifikuara në Mocionin e Dytë sipas Rregullës 154;⁶ dhe (ii) të autorizojë Zyrën Administrative që të përditësojë radhën përkatëse të paraqitjes në *Legal Workflow*.⁷ Lidhur me W04474-ën, ZPS-ja parashtron se dokumenti i lidhur me përkthimin në anglishte të një prove materiale⁸ në radhën e paraqitjes të nxjerrë nga ZPS-ja më 22 shkurt 2023 (në lidhje me Mocionin e Parë sipas Rregullës 154)⁹ përkon me një material tjetër dhe nuk përputhet me ERN-në e dokumentit në fjalë.¹⁰ Rrjedhimisht, ZPS-ja kërkon që Trupi Gjykses të autorizojë Zyrën Administrative që të zëvendësojë dokumentin që është aktualisht i lidhur me dokumentin e saktë.¹¹

9. Sa i përket W04577-ës, duke pasur parasysh se me përditësimin e kërkuar, ZPS-ja synon të japë versione të rishikuara dhe përkthime të pjesshme të transkripteve të W04577-ës të krijuara pas diskutimeve *inter partes*, Trupi Gjykses

⁵ F01508, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë Lidhur me Materialet në Lidhje me W02618-ën*, 8 maj 2023.

⁶ *Shih* Kërkesën e Parë, poshtëshënimi 3, duke iu referuar Shtojcës 3 të Mocionit të Dytë sipas Rregullës 154. Sipas ZPS-së: (i) transkriptet relevante lidhen me ERN 106438; dhe (ii) dokumentet janë lëshuar si pjesë e radhës së paraqitjes 20230301_KSC-BC-2020-06-F01396_SPO.

⁷ Kërkesa e Parë, para. 1-3, 8.

⁸ 067231-067231-ET (Paketa 656 e Materialit të Nxjerrë)

⁹ 20230207_KSC-BC-2020-06-F01262_SPO.

¹⁰ Kërkesa e Parë, para. 5 dhe poshtëshënimi 10 (“Megjithëse ERN-ja e përkthimit është e saktë 067231-067231-ET, materiali i lidhur është f. 066680 nga 066676-066696-ET, siç është shënuar në kreun e faqeve të materialit.”).

¹¹ Kërkesa e Parë, para. 1, 6, 8.

autorizon Zyrën Administrative që të përditësojë radhën e paraqitjes për Mocionin e Dytë sipas Rregullës 154 (20230301_KSC-BC-2020-06-F01396_SPO) duke zëvendësuar kur është relevante transkriptet lidhur me ERN 106438 me dokumentet e nxjerra nga ZPS-ja në Paketën 745 të Materialit të Nxjerrë të 5 prillit 2023. Rrjedhimisht, miratohet pjesa e Kërkesës së Parë që ka të bëjë me W04577-ën.¹²

10. Lidhur me W04474-ën, Trupi Gjykses kujton se ERN 067231-067231 RED dhe përkthimi i tij i saktë në anglishte 067231-067231-ET i Rishikuar janë pranuar ndërkohë si prova.¹³ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses e gjykon të tejkaluar pjesën e Kërkesës së Parë që ka të bëjë me W04474-ën,.

B. KËRKESA E DYTË (F01508)

11. ZPS-ja kërkon që Trupi Gjykses: (i) të pranojë transkriptet e rishikuara të intervistës dhe përkthimet e tyre, si dhe përkthimin e rishikuar të një prove materiale të lidhur me to në lidhje me W02618-ën, që ZPS-ja i ka nxjerrë në Paketën 777 të Materialit të Nxjerrë të 4 majit 2023, në vend se të nxjerrë materialet relevante të identifikuar në Mocionin sipas Rregullës 155;¹⁴ dhe (ii) të autorizojë Zyrën Administrative që të përditësojë radhën përkatëse të paraqitjes në *Legal Workflow*.¹⁵

¹² Duke vendosur kështu, Trupi Gjykses kupton se Kërkesa e Parë ka të bëjë vetëm me zëvendësimin e dokumenteve në radhën e paraqitjes të Mocionit të Dytë sipas Rregullës 154 (*shih* paragrafët 1 dhe 8 të Kërkesës së Parë). Parashtrimet e ZPS-së në mbështetje të pranimi të atyre dokumenteve si prova janë bërë në Mocionin e Dytë sipas Rregullës 154, dhe jo në Kërkesën e Parë. Trupi Gjykses nuk nxjerr konstatime për pranueshmërinë e dokumenteve relevante në këtë vendim. Pranueshmëria do të trajtohet në vendimin e ardhshëm të Trupit Gjykses në lidhje me Mocionin e Dytë sipas Rregullës 154.

¹³ Provat materiale P00035 dhe P00035_ET.

¹⁴ *Shih* Kërkesën e Dytë, poshtëshënimi 2, *duke iu referuar* Shtojcës 11 të Mocionit sipas Rregullës 155. Sipas ZPS-së: (i) transkriptet relevante janë në lidhje me ERN 086914; (ii) prova materiale relevante që ka lidhje me të është SITF00189153-SITF00189178; dhe (iii) dokumentet u lëshuan si pjesë e radhës së paraqitjes 20230301_KSC-BC-2020-06-F01329_SPO.

¹⁵ Kërkesa e Dytë, para. 1-2.

12. Duke pasur parasysh se versionet e rishikuara të dokumenteve të lartpërmendura janë nxjerrë për Mbrojtjen dhe se Mbrojtja nuk ka kundërshtuar zëvendësimin e kërkuar nga ZPS-ja, Trupi Gjykses autorizon Zyrën Administrative që të përditësojë radhën e paraqitjes për Mocionin sipas Rregullës 155 (20230301_KSC-BC-2020-06-F01329_SPO) duke zëvendësuar, kur është relevante, transkriptet (përfshirë përkthimet) në lidhje me ERN 086914 si dhe përkthimin në anglishte të provës materiale SITF00189153-SITF00189178 që lidhet me të, me dokumentet përkatëse që ZPS-ja ka nxjerrë në Paketën 777 të Materialit të Nxjerrë të 4 majit 2023. Rrjedhimisht, miratohet Kërkesa e Dytë.¹⁶

III. KLASIFIKIMI

13. Duke vënë në dukje se ZPS-ja nuk kundërshton riklasifikimin si publike të Kërkesës së Parë, Trupi Gjykses urdhëron Zyrën Administrative që të riklasifikojë Kërkesën e Parë (F01435) si publike.

IV. VENDIM

14. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **MIRATON** pjesën e Kërkesës së Parë që ka lidhje me W04577-ën;
- b) **KONSTATON** se pjesa e Kërkesës së Parë që ka lidhje me W04474-ën është e tejkualuar;
- c) **MIRATON** Kërkesën e Dytë;
- d) **AUTORIZON** Zyrën Administrative që të veprojë siç është shtjelluar në paragrafët 9 dhe 12 më lart në lidhje me radhët e paraqitjes; dhe

¹⁶ Duke vendosur kështu, Trupi Gjykses kupton se Kërkesa e Dytë ka të bëjë vetëm me zëvendësimin e dokumenteve në radhën e paraqitjes së Mocionit sipas Rregullës 155 (*shih* paragrafët 1-2 të Kërkesës së Dytë). Parashtrimet e ZPS-së në mbështetje të pranimi të atyre dokumenteve si prova janë bërë në Mocionin sipas Rregullës 155, e jo në Kërkesën e Dytë. Trupi Gjykses nuk nxjerr asnjë konstatim në këtë vendim në lidhje me pranueshmërinë e dokumenteve relevante. Pranueshmëria do të trajtohet në vendimin e ardhshëm të Trupit Gjykses mbi Mocionin sipas Rregullës 155.

- e) **URDHËRON** Zyrën Administrative që të riklasifikojë Kërkesën e Parë (F01435) si publike.

_____/nënshkrimi/____

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E mërkurë, 24 maj 2023

Në Hagë, Holandë.

Shpjegim:

Në titullin e vendimit, numri i protokollimit është ndryshuar nga F01453 në F01435.